



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS
APELACIONI SUD KOSOVO – THE APPELLATE COURT OF KOSOVO

Prishtinë : 09.06.2017

Bazuar në Ligjin Nr.06L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 21/2012, Për Avancimin ne Karrierë te Nëpunësve Civil dhe Udhëzimit Administrativ 01/2015,i nxjerr nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Kryetari i Gjykatës së Apelit, me dt.09.06.2017 : merr këtë:

VENDIM

-Mbi Anulimin e Procedurës së Rekrutimit

I. **ANULOHET**, procedura e rekrutimit sipas konkursit te brendshëm nr.10/2017, i shpallur në Gjykatën e Apelit të Kosovës, me dt. 26.05.2017, për pozitën, Referent i Lartë, si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedur e rekrutimit.

II. **OBLIGOHET**, Njësia e Personelit në Gjykatën e Apelit që vendimin mbi anulimin e konkursit, ta publikoi në Web-faqen e Gjykatës së Apeli.

III. **OBLIGOHET**, Njësia e Personelit në Gjykatën e Apelit që të përgaditë procedurën e nevojshme për shpalljen e konkursit, konform Ligjit Nr.03/L-149,Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2010, Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr. 21/2012, Për Avancimin ne Karrierë te Nëpunësve Civil.

Arsyetim

Gjykata e Apelit, me konkursin e brendshëm nr.10 /2017 të datës, 26.05.2017, ka shpallur, pozitën, Referent i Lartë në Gjykatën e Apeli, i cili ka qen i hapur nga data 26.05.2017 deri me datën, 02.06.2017. Brenda kësaj periudhe kanë aplikuar gjithsejtë 3 (tre) kandidatë për këtë pozitë.

Me dt. 09.06.2017, KPSHC-ë, në Gjykatën e Apelit, ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjitha aplikacionet dhe në bazë të kriterëve të konkursit ka konstatuar se nga numri i 3(tre) i aplikacioneve të pranuar,1 (një), nuk i përmbush kriteret e konkursit. Andaj, ka propozuar që procedura e rekrutimit të ndërpritet dhe të publikohet pozita e njëjtë në mbështetje të dispozitave ligjore.

Bazuar në propozimin e KPSHC-ë dhe dispozitave ligjore të lartcekura është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopja ju dërgohet :

1. Njesisë së Personelit në Gjykatën e Apelit
2. Arkiv ës


Kryetar në Gjykatën e Apelit